



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT  
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN  
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 606/1 Prot.

Tiranë, më 22.02.2022

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1711, datë 29.05.2014.

SHOQËRISË “ALBA CHINA” SH.P.K  
Ish Poligoni i qitjes, Fshat Prrenjas, Elbasan

**Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE  
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA  
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “ALBA CHINA” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1711, datë 29.05.2014, për mineralin Gëlqeror i mermerizuar, në objektin “Pishkash”, Bashkia Prrenjas.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.342, datë 20.01.2022, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.606, Prot, datë 21.01.2022, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1711, datë 29.05.2014, për mineralin Gëlqeror i mermerizuar, në objektin “Pishkash”, Bashkia Prrenjas pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar lidhur me miratimin e planit vjetor te punës për vitin 2021-2022 dhe nuk ka filluar aktivitetin minerar që nga data e marrjes së lejes minerare të shfrytëzimit.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, shkronja “b”, “ii” & “c” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr.1711, datë 29.05.2014, për mineralin Gëlqeror i mermerizuar, në objektin “Pishkash”, Bashkia Prrenjas që shoqëria Juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1711, datë 29.05.2014, për mineralin Gur gëlqeror, në objektin “Pishkash”, Bashkia Prrenjas.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

**MINISTRI**  
**BELINDA BALLUKU**  
**ME AUTORIZIM**  
**ZËVENDËSMINISTRI**  
**ILIR BEJTJA**

